



Prishtinë, 27 nëntor 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1192\_2019

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Neni 15 dhe Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05 -L-084;
- Dispozitat e Nenit 20 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05-L-052; dhe
- Amendamentin e Marrëveshjes për Furnizim me Ngrohje në mes të KEK Gjenerimi SH.A dhe NQ Termokos SH.A , dorëzuar për aprovim ne ZRRE me datën 24 tetor 2019.

**në seancën e mbajtur me datë 27 nëntor 2019, nxori këtë:**

## VENDIM

- I. **APROVOHET** Amendamenti i "Marrëveshjes për furnizim me ngrohje e lidhur me datën 24.12.2014, nr 252 " në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. dhe NQ Termokos sh.a.

### Arsyetim

- o Me datën 24 tetor 2019, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar propozim Amendamentin - "Aneks marrëveshje për caktimin e çmimit të energjisë termike për furnizim me ngrohje", i cili është lidhur mes KEK sh.a. – NQ Termokos sh.a. me datë 22 tetor 2019.
- o Amendamenti i bashkangjitur i përmban katër nene:
  - Neni 1, me të cilin mbulohet perioda e vlefshmërisë së aneks marrëveshjes –nga data e 15 tetor 2019 deri më 15 prill 2020 ,
  - Neni 2 , me të cilën ndryshohen 2(dy) paragrafë të Shtojcës IV të marrëveshjes bazë. Ky ndryshim është rrjedhojë e de-rregullimit të gjeneratorit të energjisë elektrike (KEK Sh. A). Më konkretisht, çmimet e energjisë termike i referohen çmimit të energjisë elektrike që KEK gjenerimi i ofron furnizuesit të shërbimit universal (FSHU) në vlerën prej 29.50€/MWh, si dhe koston shtesë prej 0.91 €/MWh për të mbuluar koston e konsumit të energjisë elektrike në stacionin e ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B(HES), në bazë të metodologjisë së dakorduar paraprakisht mes KEK- NQ Termokos -ZRRE.
  - Nenin 3, me të cilin palët pajtohen që çmimi bazë i rrikalkuluar sipas nenit 2 të jetë 30.41 €/MWh.
  - Nenin 4, me të cilin palët pajtohen që çmimi i energjisë termike për periudhën sipas Nenit 1 të jetë në nivelin 1.39 €/MWh ndërsa për kapacitetin elektrik të jetë në nivelin 21.28 €/MWh/h.



- o Dispozitat tjera të marrëveshjes bazë e nënshkruar me datën 24 dhjetor 2014 dhe aprovuar nga ZRRE me datën 23 dhjetor 2014 me vendimin V\_677\_2014 mbeten në fuqi.
  - o Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e Amendamentit në fjalë, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. kryesues

  
Besim Selmaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar